



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Primjenaj/Prodato Received/Delivery	18-07	2023	viti god year
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHANGHCK	5277/2023		113



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.743/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Rushit Kajtazi -Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr. 743/2023, të datës 17.05.2023, të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi

nga Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, në çështjen juridike “vlerësim i punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 17.07.2023, mori këtë:

### V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr. 743/2023, të datës 17.05.2023, të parashtruar nga ankuesja

### A r s y e t i m

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me vendim A. Nr. 416/2023 datë 27.03.2023, ka aprovuar ankesën e ankueses si të bazuar, duke e obliguar Udhëheqësen e Divizionit të Integritimit Evropian, të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukture, si mbikëqyrës e drejtpërdrejtë e ankueses, në afatin prej (15) ditësh ta bëjë vlerësimin e rezultateve në punë, për periudhën nga muaj gusht deri në muajin dhjetor të vitit 2022.

Udhëheqësja e Divizionit të Integritimit Evropian, të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukture, në qellim të zbatimit të Vendimit me vendim A. Nr. 416/2023 datë 27.03.2023, të këshillit, me datë 03.05.2023, ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë, duke e vlerësuar ankuesen me notën e përgjithshme një pike pesëdhjetë e pesë (1.55).

Ankuesja e pakënaqur me vlerësimin e rezultateve në punë, të bërë nga Udhëheqësja e Divizionit të Integritimit Evropian, të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit

Hapësinor dhe Infrastruktura, me datë 17.05.2023, me numër protokoll 4267/2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën e datës 17.05.2023, e parashtruar nga ankuesja me numër protokoll 4267/2023, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; e-maili i datës 12.05.2023; e-maili i datës 10.05.2023; Ankesë e datës 24.02.2023, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi A. nr. 416/2023, të datës 27.03.2023, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formuari për Vlerësimin e rezultateve në punë i datës 03.05.2023; e-maili i datës 12.08.2023; e-maili i datës 03.08.2023; e-maili i datës 09.08.2023; e-maili i datës 22.08.2023; e-maili i datës 26.08.2023; e-maili i datës 29.09.2022; e-maili i datës 30.09.2022; e-maili i datës 07.10.2022; e-maili i datës 13.10.2022; e-maili i datës 14.10.2022; e-maili i datës 12.10.2022; e-maili i datës 14.10.2022; e-maili i datës 20.10.2022; e-maili i datës 25.10.2022; e-maili i datës 26.10.2022; e-maili i datës 31.10.2022; e-maili i datës 23.12.2022; e-maili i datës 20.01.2023; e-maili i datës 06.03.2023; e-maili i datës 12.05.2023; e-maili i datës 27.02.2023; e-maili i datës 24.02.2023; e-maili i datës 09.03.2023; e-maili i datës 15.03.2023; e-maili i datës 16.05.2023; e-maili i datës 17.03.2023; e-maili i datës 17.03.2023; e-maili i datës 20.03.2023; e-maili i datës 24.03.2023; e-maili i datës 04.05.2023; e-maili i datës 02.05.2023; e-maili i datës 03.05.2023; e-maili i datës 25.03.2023; e-maili i datës 24.03.2023; e-maili i datës 20.03.2023; e-maili i datës 19.03.2023; e-maili i datës 18.03.2023; e-maili i datës 07.03.2023; e-maili i datës 06.03.2023; e-maili i datës 31.03.2023; e-maili i datës 30.03.2023; e-maili i datës 24.03.2023; e-maili i datës 03.03.2023; e-maili i datës 12.05.2023; e-maili i datës 12.05.2023; e-maili i datës 27.01.2023; e-maili i datës 19.08.2023; e-maili i datës 29.09.2023; e-maili i datës 20.02.2023; e-maili i datës 23.12.2023; e-maili i datës 26.10.2023; e-maili i datës 25.10.2023; e-maili i datës 03.05.2023; E - maili i datës 28.11.2022; E - maili i datës 24.02.2022; E - maili i datës 27.03.2022; E - maili i datës 05.06.2023; Përgjigje në ankesë e datës 06.07.2023, me numër protokoll 743/2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat materiale të çështjes në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e pa bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me vendim A. Nr. 416/2023 datë 27.03.2023, ka aprovuar ankesën e ankueses duke e obliguar Udhëheqësen e Divizionit të Integritetit Evropian, të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktura, si mbikëqyrës e drejtpërdrejtë e ankueses, që në afatin prej (15) ditësh ta bëjë vlerësimin e rezultateve në punë, për periudhën nga muaj gusht deri në muajin dhjetor të vitit 2022.

Kolegji i Këshillit gjatë vlerësimit të pretendimeve të ankueses ka marrë për bazë vlerësimin e punës të bërë nga ana e mbikëqyrësit të ankueses për periudhën nga data 01.01.2022 deri më datë 31.07.2022, ku ankuesja ka qenë e vlerësuar me notë të përgjithshme 4.99, si dhe vlerësimin e punës për periudhën nga data 01.08. deri më datë 31.12.2022 ku ankuesja është vlerësuar me notë të përgjithshme 1.55 nga ana e mbikëqyrëses së drejtpërdrejtë (vlerësimi është bërë në zbatim të vendimit të KPMSHCK A.nr. 416/2023).

Duke i nisur nga vlerësimet e lartshënuara Kolegji ka bërë bashkimin e notave të përgjithshme të vlerësimit të punës dhe ka konstatuar se nota e përgjithshme e vlerësimit të punës së ankueses për vitin 2022 është 3.27.

Me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses sa i përket notës së përgjithshme të vlerësimit, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik nën paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 ku përcaktohet se: *“Objektivat dhe sjelljet profesionale do të vlerësohen me nota nga 1 deri në 5. Rezultati përfundimtar i vlerësimit llogaritet në bazë të mesatares së marrë dhe paraqitur si në vijim: 1.3. nga 2.5 deri më pak se 3.5 nënkupton “mirë”; dhe”* ndërlidhur me paragrafin 2 nën paragrafin 2.3 i të njëjtit nen dhe rregullore ku përcaktohet se: *“ Kuptimi i notave si në paragrafin 1 të këtij neni është si në vijim: “ mirë”, vlerësohet nëpunësi, vlerësohet nëpunësi, i cili ka realizuar të gjitha objektivat e punës, dhe ka treguar aftësi të pritshme të punës,* prandaj marrë për bazë dy Formularët për Vlerësimin e Rezultateve në Punë për ankuesen përmes të cilëve ankuesja është vlerësuar me notë të përgjithshme mesatare 3.27, Kolegji i Këshillit arrin në përfundimin se ankuesja është vlerësuar *“mirë”* në kuptim të dispozitave të lartcekura të rregullores, nga rrjedh se e njëjta ka realizuar të gjitha objektivat e punës.

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda Nr. A. Nr. 743/2023**

**Rushit KAJTAZI**

Procesmbajtës

**Eshref SHABANI**

Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë;
- Arkivit të KPMSHCK-së